

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

OPTIMA COMMUNICATION

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K71903025A

NUIS/NIPT

Rruga Gjin Bue Shpata, godina av. Vjeter, Hyrja 7, Ap. 34, Tirane, Shqiperi

Adresa

Tiranë

Albania

1019

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0672044803

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

eltonrama@yahoo.com

E-mail

Administrator Elton Rama

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2024/03/12

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+355672044803

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-97588-03-06-2024

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Bashkia Lezhe

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

3408025

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Blerje paisje kompiuterike për nevoja të Administratës dhe Drejtorisë së Urbanistikës pranë Bashkisë Lezhe .

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2024/03/18

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Mallra

Data e zhvillimit të procedurës

2024/03/18

Numri i njoftimit

CN/44145/03062024

Kodi CPV

30200000-130211100-230213000-5

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji i Prokurimit Publik nr. 162 dt. 23.12.2020, neni 110, si edhe Rregullat e Prokurimit Publik, neni 94 dhe neni 97

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disë operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Kompania Optima Communication sh.p.k. me NUIS K71903025A, shpreh interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje paisje kompiuterike për nevojat e Administratës dhe Drejtorisë së Urbanistikës pranë Bashkisë Lezhë”, publikuar në faqen e APP-së nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë me datë 07.03.2024, dhe parashikuar për të zhvilluar në datë 18.03.2024.

Në gjykimin tonë, disa kërkesa dhe kritere për kualifikim të vendosura nga AK në këtë procedurë janë në shkelje të LPP, prandaj bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik nr. 162 dt. 23.12.2020, neni 110, si edhe Rregullat e Prokurimit Publik, neni 94 dhe neni 97, po paraqesim këtë ankesë.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Kompania Optima Communication sh.p.k. me NUIS K71903025A, shpreh interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje paisje kompiuterike për nevojat e Administratës dhe Drejtorisë së Urbanistikës pranë Bashkisë Lezhë”, publikuar në faqen e APP-së nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë me datë 07.03.2024, dhe parashikuar për të zhvilluar në datë 18.03.2024.

Në gjykimin tonë, disa kërkesa dhe kritere për kualifikim të vendosura nga AK në këtë procedurë janë në shkelje të LPP, prandaj bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik nr. 162 dt. 23.12.2020, neni 110, si edhe Rregullat e Prokurimit Publik, neni 94 dhe neni 97, po paraqesim këtë ankesë.

PIKA 1

Ne Njoftimin e Kontrates - Seksioni 1: Autoriteti Kontraktor, është përcaktuar:

2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:

Kohëzgjatja në muaj ??? ose ditë 10

ARGUMENT 1

Afati 10 ditor për levrime është shumë i shkurtër për procedurën e tillë. Në procedurën e ndryshme të prokurimit të zhvilluar nga AK të ndryshme, kerkohen lloje nga me të ndryshmet të pajisjeve kompjuterike, dhe është e pamundur për një OE të mbajë gjendje në magazine të gjitha llojet e pajisjeve, në sasi të kërkuara. Patjetër që OE kanë nevojë të furnizohen në momentin që shpallen fitues të një procedure të caktuar. Sjellim në vëmendje që pajisjet kompjuterike nuk prodhohen në Shqipëri, vijnë nga jashtë shtetit, dhe afati 10 ditë është teresisht i pamjaftueshëm për të bërë porosi tek furnoret e huaja, për të importuar furnizime nga jashtë shtetit, për të bërë procedurat e detyrueshme të zhdoganimit, magazinimit dhe levrimit të mallit të AK. Mendoni që brenda këtyre 10 ditëve mund të ndodhë që 2 deri në 4 ditë të jenë pushim fundjave.

Një tender me afat kaq të shkurtër levrimit mund të realizohet vetëm nga ndonjë OE i caktuar që e ka gjendje mallin në magazine, duke përjashtuar nga prokurimi të gjithë operatorët e tjerë, të cilët mund të ofrojnë edhe çmime shumë të favorshme për AK, por nuk mund të ofertojnë për shkak të pengesës që vendos një afat kaq të shkurtër të zbatimit.

Të tilla afate levrimi janë diskutimuese dhe pengojnë konkurrencën në procedurën e prokurimit, duke

mos lejuar ofertimin sidomos per biznesin e vogel dhe te mesem. Gjithashtu shkelin nenin 77 te LPP pasi nuk jane ne perpjestim me permasat e kontrates qe po prokurohet. Sjellin ne vemendje se mallrat qe po prokurohen jane pajisje kompjuterike, pra nuk jane mallra emergjence, perkundrazi jane aktive afatgjata, prandaj nuk ka asnje arsye pse duhet te kene nje afat levrimi kaq te shkurter.

Neni 2, 3 dhe 21 i LPP ngarkon AK me detyrimin te planifikoje dhe zhvilloje ne kohe procedurat e prokurimit:

Neni 2 Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3 Parime të përgjithshme

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Neni 21

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

dhe nuk ka pse OE te vuajne barren e afateve kaq te shkurtra te levrimin, sikur kjo te ishte nje emergjence.

Gjithashtu ne proces-verbalin e argumentimit te kritereve nuk gjejme asnje sqarim se perse AK ka vendosur nje afat te tille levrimi dhe nuk ka marre masat per zhvillimin ne kohe te procedures dhe per ti mundesuar OE kohen e domosdoshme per realizimin e kontrates.

Bazuar edhe ne vendimin Nr. 1254/2023, si edhe ne sa me lart, kerkojme qe AK te vendose nje afat levrimi se paku 60 ditore, ne raport me sasine dhe volumin e kontrates, sic jane zakonisht afatet e levrimin ne procedura me te tilla permasa kaq te medha.

PIKA 2

Ne Shtojcen 7 – kriteret e vecanta per kualifikim, eshte kerkuar:

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë staf te kualifikuar dhe te figuroje ne listpagesa per periudhen Nentor 2023- Janar 2024, si me poshte:

- 1 (nje) specialist te certifikuar per pajisjet kompjuter qe do te ofrohen nga OE
 - 1 (nje) specialist te certifikuar per instalimin dhe konfigurimin e pajisjes Router.
- ? Per te provuar disponimin e stafit te kërkuar, OE duhet te paraqese:
- a. Listpagesat per periudhen Nentor 2023- Janar 2024
 - b. Certifikatat perkatese sipas kerkesave te mesiperme.

ARGUMENT 2

Kjo eshte nje procedure prokurimi “mallra” dhe objekti I procedures eshte “Blerje paisje kompiuterike per nevoja te Administrates dhe Drejtorise se Urbanistikes prane Bashkise Lezhe”. Sic e shohim edhe ne shtojcen 6, AK ka parashikuar vetem blerjen e mallrave dhe nuk kerkohet nga OE qe te kryejne asnje sherbim:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Kompjuter desktop 1 (sipas specifikimeve te AKSHI)	cope	12
2	Kompjuter workstation sipas prodhuesit (sipas specifikimeve te AKSHI)	cope	4
3	Kompjuter workstation advanced sipas prodhuesit (sipas specifikimeve te AKSHI)	cope	1
4	Switch L2 me 24 porta (sipas specifikimeve te AKSHI)	cope	1
5	UPS 1000 VA (sipas specifikimeve te AKSHI)	cope	6
6	Router wireless wifi (sipas specifikimeve te AKSHI)	cope	3

Ne keto kushte kerkesa per 1 (nje) specialist te certifikuar per pajisjet kompjuter dhe 1 (nje) specialist te certifikuar per instalimin dhe konfigurimin e pajisjes Router, nuk eshte ne perputhje me objektin e prokurimit dhe nuk ka lidhje me proceduren. Nuk eshte kerkuar asnje sherbim per kompjuterat, as instalim apo konfigurim i asnje pajisje ne kete procedure, prandaj kerkesa per specialiste per pajisje kompjuter apo per specialist per instalimin dhe konfigurimin e pajisjes Router shkon pertej asaj cfare kerkohet ne kete objekt prokurimi.

Per sa kohe qe nuk eshte kerkuar asnje sherbim nga ana e OE, instalimet dhe konfigurimet AK i realizon permes specialisteve te vet IT.

Per me teper kjo eshte procedure e hapur e thjeshtuar per mallra, dhe sipas percaktimeve te nenit 55, pika 4, te ne VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, I ndryshuar, AK duhet te vendosin kriteret e thjeshtuara pranimi:

4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Per procedurat e hapura te thjeshtuara, neni 55, ne VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, I ndryshuar, nuk parashikon qe AK te vendose kerkesa per punonjes apo specialiste:

1. Procedura e hapur e thjeshtuar është një procedurë me një fazë, që mund përdoret nga autoriteti kontraktor për kontrata nën kufirin e ulët monetar, sipas parashikimit në nenin 49, të LPP-s?

2. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë një ofertë në procedurë?

3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 49, të LPP-së.

4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:

a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

5. Shqyrtimi i ofertave duhet të bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dorëzimi i ofertave.

6. Në përfundim të procesit të vlerësimit të dokumentacionit të ofertuesve, në bazë të kritereve të përcaktuara në nenin 76 e 77, të LPP-së dhe këtyre rregullave, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 87, të LPP-së.

Ne process-verbalin e argumentimit të kritereve, lidhur me këto kërkesa, thuhet:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja b dhe c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Sipas percaktimeve te nenit 78, pika 2, te ne VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, I ndryshuar:

2. Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specififikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit.

AK duhet te argumentoje ligjerisht dhe teknikisht cdo kriter qe vendos. AK nuk ka dhene asnje sqarim se cfare funksioni konkretisht do te kete keta specialiste ne kete procedure per sa kohe qe AK po kerkon vetem te bleje mallra dhe asnje sherbim tjetet.

Madje ne Kriteret e Vecanta per Kualifikim ne kete procedure eshte kerkuar qe OE te deklarojne se:

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate ku merr persiper furnizimin, vendosjen, e mallrave objekt prokurimi me stafin e tij brenda vleres se ofertuar.

Pra vete AK ka kerkuar qe OE te deklarojne se nuk do te bejne asnje sherbim tjetet pervec furnizim, vendosje (OE nuk do te bejne as instalim, as konfigurim).

Bazuar ne sa me lart kerkojme heqjen e kriterit

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë staf të kualifikuar dhe të figurojë në listpagesa për periudhën Nentor 2023- Janar 2024, si më poshte:

- 1 (nje) specialist te certifikuar per pajisjet kompjuter qe do te ofrohen nga OE
- 1 (nje) specialist te certifikuar per instalimin dhe konfigurimin e pajisjes Router.

? Per te provuar disponimin e stafit te kerkuar, OE duhet te paraqese:

- c. Listpagesat per periudhen Nentor 2023- Janar 2024
- d. Certifikatat perkatese sipas kerkesave te mesiperme.

Pasi eshte ne kundershkrim te referencave ligjore te mesiperme, nuk ka lidhje me proceduren, dhe nuk I sherben ketij objekti prokurimi.

NE PERFUNDIM

Ne kete procedure jane shkelur nje seri nenesh te ligjit te prokurimit public si edhe te rregullave te prokurimit:

Ligji i Prokurimit Publik nr. 162 dt. 23.12.2020, neni 2 dhe 3:

Neni 2

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

- c) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Pasi kriteret e ankimuar janë pengese për ofertim, kufizim i konkurrencës, nuk garantojnë trajtim të barabartë të OE.

Ligji I Prokurimit Publik nr. 162 dt. 23.12.2020, neni 77:

Neni 77

Kërkesat për kualifikim

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Kerkesat e vendosura per kualifikim nuk I sherbejne qellimit te procedures, nuk kane lidhje me llojin e procedures dhe as me ate qe AK kerkon, jane vendosur kerkesa qe pengojne konkurencen dhe nuk I japin AK asnje garanci per furnizimin qe eshte object I kontrates.

VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, I ndryshuar, neni 55 dhe neni 78:

Neni 55

Procedurë e hapur e thjeshtuar

1. Procedura e hapur e thjeshtuar është një procedurë me një fazë, q? mund p?rdoret nga autoriteti kontraktor për kontrata nën kufirin e ulët monetar, sipas parashikimit n? nenin 49, t? LPP-s?.

2. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Çdo operator ekonomik i interesuar mund t? paraqes? nj? ofert? n? k?t? procedur?.

3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë jan? ato t? parashikuara në nenin 49, të LPP-së.

4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:

c) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

d) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

5. Shqyrtimi i ofertave duhet të bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dorëzimi i ofertave.

6. Në përfundim të procesit të vlerësimit të dokumentacionit të ofertuesve, në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenet 76 e 77, të LPP-së dhe k?tyre rregullave, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 87, të LPP-së.

Neni 78

Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit

1. Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit, sipas llojit të procedurës e tipit të kontratës.

2. Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specififikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit.

3. Nëse gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, përpara publikimit të një procedure prokurimi, njësia e prokurimit ka nevojë për asistencë, komunikon me APP-në, për të marrë një mendim të specializuar mbi mënyrën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik. Me qëllim dhënien e asistencës, ngritjen e kapaciteteve dhe sigurimin e mirëzbatimit të legjislacionit të prokurimit publik, APP, në koordinim me personin/at përgjegjës për prokurimin mund të asistojë këto të fundit gjatë përgatitjes të dokumenteve të tenderit në përputhje me dokumentet standarde të tenderit dhe rregullat e prokurimit publik.

Për efekt shpejtësie, komunikimi me APP-në për koordinimin e veprimtarisë gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit dhe marrjes së asistencës mund të bëhet me mjete elektronike (me e-mail).

Afatet dhe procedura e detajuar e koordinimit të veprimtarisë së njësisë të prokurimit me APP-në, në funksion të marrjes së asistencës dhe ngritjes së kapaciteteve, rregullohen me udhëzim të APP-së.

4. Pas nënshkrimit të njoftimit të kontratës nga titullari i autoritetit kontraktor, personi/at përgjegjës për prokurimin dërgon/jnë dokumentet e tenderit dhe procesverbalin e argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, për publikim, në përputhje me nenet 55 e 56, të LPP-së.

5. Në procedurat e prokurimit me mjete elektronike, publikimi i njoftimit të kontratës, dokumenteve të tenderit dhe procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

AK nuk ka argumentuar kerkesat e vendosura.

Bazuar ne sa me lart kerkojme pezullimin e procedures, dhe ndryshimin/heqjen e kriterëve te ankimuara.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonte)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

n/a

7. Lista e informacionit konfidencial:

n/a

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

eltonrama@yahoo.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Elton Rama